

20110360865

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM TË**  
**DETYRUESHËM PENSIONAL ME FINANCIM KAPITAL**

Neni 1

Në Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/10 dhe 171/10) në nenin 105 paragrafi (1) pika gj) ndryshohet si vijon:

"aksionet e shoqërive aksionare vendase që nuk janë fonde të mbyllura investuese, të lëshuara në bazë të lejes së Komisionit për Letra me Vlerë të Republikës së Maqedonisë dhe që kuotojnë në tregun zyrtar ose tregtohen në tregun e shoqërive aksionare me detyrime të posaçme për investim në kuadër të tregut të rregullt të bursës së letrave me vlerë ose në treg tjetër të organizuar të letrave me vlerë në Republikën e Maqedonisë që e kontrollon Komisioni;"

Pika z) ndryshohet si vijon:

"dokumentet për pjesëmarrjet dhe aksionet e fondeve të hapura investuese, fondeve të mbyllura investuese dhe fondeve investuese private të regjistruara në Komisionin për Letra me Vlerë të Republikës së Maqedonisë, me ç'rast mjetet e fondeve investuese private investohen në aksionet dhe pjesëmarrjet e shoqërive më të vogla, të vogla dhe të mesme tregtare në Republikën e Maqedonisë, të përkufizuara me Ligjin për shoqëri tregtare;"

Pika k) ndryshohet si vijon:

"dokumentet për pjesëmarrje, aksionet dhe instrumentet tjera të lëshuara nga fondet e autorizuar investuese me seli në shtetin - anëtar të UE-së ose të OECD-së, që kanë investuar kryesisht në instrumente që kuotojnë në bursat e atyre shteteve dhe politika investuese e të cilave e lejon shfrytëzimin e instrumenteve derivative më së shumti deri në 20% të mjeteve të fondit investues, vetëm me qëllim të mbrojtjes së mjeteve dhe detyrimeve të fondit investues ose për realizim më efikas të qëllimeve të politikës investuese të fondeve investuese, që i ndjekin performansat e indeksit të caktuar dhe".

Neni 2

Në nenin 106 paragrafi (1) në fjalinë e dytë pas fjalës "emetuesit" pika zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: "kurse në dokumentet për pjesëmarrje dhe aksione të fondeve investuese mund të investohen mjete më së shumti deri në 10% nga numri i përgjithshëm i pjesëmarrjeve dhe aksioneve të fondit të veçantë investues".

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon.

"Më së shumti 5% nga vlera e mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional mund të investohen në instrumente të lëshuara nga subjekti i njëjtë që nuk është themeluar nga shteti dhe është i regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë ose në shtetin - anëtar të UE-së ose OECD-së, përveç në depozita dhe certifikatat për depozitë. Më së shumti deri në 7,5% nga mjetet e fondit të detyrueshëm pensional mund të investohen në instrumente, në subjekte të këtilla të lidhura në mënyrë të ndërsjellë."

Pas paragrafit (2) shtohet paragrafi i ri (3), si vijon:

"(3) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, në pjesëmarrjet dhe aksionet e fondeve investuese të emetuara nga shoqëria e njëjtë për menaxhim nga shteti - anëtar i UE-së ose OECD-së, mund të investohen më së shumti 15% nga vlera e mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional, me ç'rast në fondin e veçantë investues mund të investohen më së shumti 5% nga vlera e mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional. Në pjesëmarrjet dhe aksionet e fondeve të hapura dhe të mbyllura investuese të emetuara nga shoqëria e njëjtë për menaxhim nga Republika e Maqedonisë, mund të investohen më së shumti 2,5% nga vlera e mjeteve të fondit të

detyrueshëm pensional, me ç'rast në fondin e veçantë investues mund të investohen më së shumti 1% nga vlera e mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional. Në pjesëmarrjet e фондеве investuese private të emetuara nga shoqëria e njëjtë për menaxhim nga Republika e Maqedonisë, mund të investohen më së shumti 1,25% nga vlera e mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional, me ç'rast në fondin e veçantë investues mund të investohen më së shumti 0,5% nga vlera e mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional.“

Paragrafët (3) dhe (4) bëhen paragrafë (4) dhe (5).

#### Neni 3

Në nenin 107 pika gj) shtohet fjalia e re si vijon: "Në kuadër të këtij kufizimi më së shumti 1,5% nga mjetet e fondit të detyrueshëm pensional mund të investohen në dokumente për pjesëmarrje të фондеве investuese private."

#### Neni 4

Në nenin 108 pika e) pas fjalës "instrumente" vihet presje dhe shtohen fjalët: "përveç investimit ndërmjetësues nëpërmjet фондеве investuese në pajtim me kufizimet nga neni 105 paragrafi (1) pika k) të këtij ligji".

#### Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".